



## BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË SLLOVAKI

### VITI AKADEMIK 2018-2019

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Sllovakinë në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës së Sllovakisë ofron 1 (një) bursë për studime universitare/ pasuniversitare në nivelin bachelor/master dhe 1 (një) bursë studimi për doktoratë (PhD) për shtetas shqiptarë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Sllovakisë për vitin akademik 2018-2019 sipas programeve të studimit në vijim:

1. Trajnimi i mësuesve dhe shkencat e edukimit;
2. Biznes dhe administrim;
3. Ekologji dhe shkencat mjedisore;
4. Arkitekturë dhe inxhinieri;
5. Inxhinieri ndërtimi, teknologji, manifakturë dhe komunikim;
6. Bujqësi;
7. Pylltari;
8. Menaxhimi i burimeve ujore.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të dërgojnë **me postë** deri më datë **23.04.2018** në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, dokumentet e mëposhtme:

#### Për studime universitare **bachelor**:

1. Kërkesën për studime universitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Vërtetimin e notave për tre vitet e shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale/Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
3. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
4. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
5. 4 (Katër) fotografi dokumenti

#### Për studime pasuniversitare **Master**:

1. Kërkesën për studime pasuniversitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Fotokopjen e noterizuar të diplomës së shkollës së lartë dhe listën e notave;
3. CV-në, në të cilën të pasqyrohen të dhëna për nivelet e studimit dhe të dhëna të tjera për punësimin nëse ka;
4. Dy letra rekomandimi;
5. Programin e studimit;
6. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
7. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;

8. 4 fotografi dokumenti.

*Për studime pasuniversitare në doktoratë (PhD):*

1. Kërkesën për studime pasuniversitare ne PhD, duke specifikuar fushën e studimit Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. CV-në, në të cilën të pasqyrohen të dhëna për nivelet e studimit dhe të dhëna të tjera për punësimin nëse ka;
3. Kopjet e noterizuara të diplomave ose të dokumenteve të ngjashëm që vërtetojnë mbarimin e programeve të studimit të nivelit të parë (bachelor) dhe të nivelit të dytë (master);
4. Kopjen e noterizuar të Supplementit të Diplomës Master, si dhe të listës së notave përkatëse;
5. Listën e botimeve të artikujve të ndryshëm (nëse ka);
6. Temën e kërkimit mbi të cilën mendohet të mbahet disertacioni (3-5 faqe);
7. Dy letra rekomandimi nga profesorë të institucioneve akademike;
8. Certifikata për kualifikime të ndryshme apo për veprimtari kërkimore;
9. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
10. Fotokopjen e faqes se pasaportës me të dhënat e identitetit;
11. 4 fotografi dokumenti.

Kandidatët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës sllovake, i cili fillon në shtator të vitit 2018. Informacion i detajuar për kursin e gjuhës sllovake gjendet në faqen: [www.cdruk.sk](http://www.cdruk.sk).

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të degëve studimore, si dhe informacione të tjera gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Sllovakisë:

[www.minedu.sk](http://www.minedu.sk);

<http://www.minedu.sk/scholarships-of-the-government-of-the-slovak-republic/>;

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**